



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM - ERZEN TIRANË

Nr. 1744 prot
13

Datë, 20 / 6 / 2019

VENDIM

Nr. 10 datë 20 / 6 / 2019

PËR

**“MIRATIMIN E LEJES PËR HAPJEN E NJË PUS-SHPIMI, AUTOSTRADA
TIRANË-DURRËS, KM.7, KASHAR, TIRANË, PËR SUBJEKTIN "... te Birra
STELA" sh.p.k**

Në zbatim të Ligjit nr.111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore" të ndryshuar, përkatësisht neni 50 pika 2 dhe neni 56 pika 2, vendimit nr. 416, datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", vendimit nr.221, datë 26.04.2018 " Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore" paragrafi III, pika 5 gërma "i", vendimit nr.5 datë, 16.02.2016 për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor" neni 16, Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

KONSTATOI SE:

- Subjektit "...te Birra Stela" sh.p.k, me vendodhje në autostradën Tiranë-Durrës, km.7, Kashar, ka paraqitur dokumentacionin, bazuar në vendimin nr.1, datë 02.05.2019, "Për shtyrjen e vendimit për miratimin e lejes për hapjen e një pus-shpimi, për subjektin "... te Birra STELA" sh.p.k, të KBU Ishëm-Erzen si më poshtë:
- Ka paraqitur çertifikatën e pronësisë të shoqëruar me kartelën e paurisë të rifreskuar.
- Ka paraqitur raportin hidrogeologjik të plotësuar me vlerësimin e përqindjes së sigurisë.

Për këto arsye Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

VENDOSI:

1. Miratimin e lejes për hapjen e një pus shpimi, për subjektin "... te Birra STELA" sh.p.k, nga shpuesi profesionist Fatos Kopaçi, me vendodhje autostrada Tiranë-Durrës, Km.7, Tiranë, me këto të dhëna:

Koordinatat në sistemin koordinativ KRRGJSH të pusit të projektuar:

- X= 478642, Y= 4580135, Z=56 m
- Kapaciteti i parashikuar 0.001 m³/s
- Thellësia e shpimit të pusit 300 m
- Diametri i shpimit të pusit 0-150 m =Ø311 mm, 150-300 m=Ø211mm
- Qëllimi i përdorimit: Ujë sanitar

2. Ngarkohet ZABU Ishëm-Erzen-Mat për zbatimin dhe mbikqyrjen e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar .

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

SEKRETAR

Adrian SHTINO



KRYETAR

Suzana JAHOLLARI

